




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0047290-2/26 dt. 12.08.2026
Mitrovicë


Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenet 7, 43 dhe 44 të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0047290/26, dt. 12.08.2026, të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës sjell këtë:


V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Ndarjen e Subvencioneve për Personat Fizik nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport pa Thirrje Publike)

1. **Formohet** Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Ndarjen e Subvencioneve për Personat Fizik nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport pa Thirrje Publike, në këtë përbërje:
 - 1.1 Arbër Hajra – kryetar (DKRS);
 - 1.2 Lule Veseli – anëtare (DKRS);
 - 1.3 Nazmi Racaj – anëtar (DKRS).
2. Komisioni është përgjegjës që të shqyrtojë të gjitha kërkesat e paraqitura për përkrahje financiare nga personat fizik që aplikojnë për subvencionim në kuadër të kësaj Drejtorie në përputhje me kriteret e përcaktuara me Rregulloren Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe Planin e Punës së Drejtorisë.
3. Komisioni i lartcekur obligohet që të shqyrtojë kërkesat në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës, dhe pas shqyrtimit të kërkesave obligohet që të përgatitë Rekomandim, e të njëjtin t'ia prezantojë Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, i cili duke u bazuar në Raport-Rekomandimin e Komisionit, nxjerrë Propozim-Vendim për Kryetarin e Komunës me qëllim të Vendim marrjes në lidhje me kërkesat.
4. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Rregulloren Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat 1 (një) vit nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Faton PEÇI



Shtojcë:

Propozim-Vendimi i DKRS-së Nr. 01-020/04-0047290/26, dt. 12.08.2026.

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit

